



UNIVERSITETI BUJQESOR I TIRANES
FAKULTETI I BUJQESISE DHE MJEDISIT
DEPARTAMENTI I AGROMJEDISIT DHE EKOLOGJISE

Tiranë, më 30. 03. 2017

Udhëzim për shkrimin e mikrotezës:

për studentët që diplomohen
në programet Master Shkencor dhe Master Profesional
të ofruar nga Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë

PËRGJEGJËSI I DEPARTAMENTIT

Prof. Dr. Seit SHALLARI

Përmbajtja

1. Hyrje

2. Procedurat për mikrotezën

2.1. Faza e parë :dakortësia për temën dhe udhëheqësi shkencor

2.2. Faza e dytë: fillimi i punës

2.3. Faza e tretë: hartimi i mikrotezës

3. Struktura e mikrotezës

4. Formati i mikrotezës

5. Rregullat e shkrimit

5.1. Shkurtime dhe akronimet

5.2. Standartet minimale për një mikroteze

6. Prezantimi

1. Hyrje

Mikroteza është një punim individual që përmbyll studimet e një studenti të Masterit Shkencor ose Profesional. Nëpërmjet mikrotezës çdo diplomant demonstron para Jurisë njohuritë e fituara gjatë kohës së studimit. Studentët e Masterit Profesional do e mbrojnë diplomën me provim shteti ose me mikrotezë në rastet kur mesatarja është mbi tetë.

Pas përfundimit të punës studenti dorëzon një punim të shkruar me më shumë se 40 faqe si dhe i nënshtrohet mbrojtjes së diplomës përpara komisionit të posaçëm. Në mënyrë që të pranohet në mbrojtje, studenti duhet të ketë përmbushur të gjithë detyrimet që parashikon programi i Masterit Shkencor apo Profesional.

Mikroteza është punë e diplomantit e udhëheqeur dhe drejtuar nga një antar i personelit akademik me titullin Dr, Prof Ass ose Prof.

Studentët duhet të marrin që herët kontakte me pedagogët për të dakortësuar udhëheqen dhe temën e studimit. Udhëheqësi i temës mund të jetë jashtë departamentit në rastet kur sigurohen standartet dhe me miratimin e Përgjegjës të Departamentit.

Mikroteza është një hulumtim i një tematike të caktuar bazuar në parimet klasike të metodave të kërkimit shkencor (i) identifikimi i problemit (ii) hartimi i hipotezës për adresimin e problematikës (iii) qëllimi dhe objektivat e studimit (iv) metodologjia (v) rezultate dhe përfundime.

Materiali i mikrotezës dhe prezantimi i saj duhet të sjellë një kontribut sado minimal të studentit që diplomohet.

2. Procedurat për mikrotezën

Procedurat për mikrotezën zhvillohen në disa faza si më poshtë.

2.1. Faza e parë : dakortësia për temën dhe udhëheqësi shkencor

Proçesi i punimit të mikrotezës fillon me përzgjedhjen e temës. Pedagogët e departamentit duhet të shpallin disa tema orjentuese për studentët të lidhura me fushën dhe interesin e studimit.

Çdo student është i lirë të vihet në kontakt me pedagogët për të dakortësuar udhëheqen dhe temën. Pas rënies dakord për udhëheqje nga një pedagog i caktuar në lidhje me një temë, përzgjedhja e temës zyrtarizohet me dorëzimin në Sekretarinë e Departamentit të Agromjedisit dhe Ekologjisë, të titullit dhe abstraktit të temës, të firmosur nga studenti dhe pedagogu udhëheqës. Një kopje të dokumentit e mban pedagogu dhe një tjetër e mban studenti.

Në këtë mënyrë zyrtarizohet tema edhe udhëheqësi i studentit. Pas dorëzimit të këtij dokumenti, studenti nuk mund të ndryshojë temën deri në sezonin pasardhës të mbrojtjes së mikrotezës.

Proçesi i punimit të një mikroteze përfshin raportimin dhe konsulencën e herë pas-hershme me udhëheqësin e temës me një periudhë kohore midis raportimeve për të cilën bien dakort studentit me udhëheqësin.

Kjo mënyrë garanton se studenti është në rrugën e duhur dhe rrit mundësinë e përgatitjes së një punimi cilësor deri në përfundim të punës.

Udhëheqësi miraton punimin dhe firmos me përgjegjësi për plotësimin e standarteve minimale të punimit.

2.2. Faza e dytë: fillimi i punës

Këshillohet që çdo student të realizojë një takim me udhëheqësin për të qartësuar qëllimin dhe objektivat e temës si dhe detyrat që duhet të plotësojë studenti. Studenti mund të hartojë një dokument të shkurtër që përshkruan problemin dhe detyrat e temës nga këndvështrimi i tij. Në varësi të njohurive paraprake që ka studenti, zakonisht hapat e parë të punimit të mikrotezës përfshijnë një fazë orientuese si psh:

- Konsultimi me literaturën dhe punë të ngjashme
- Përcaktimi me i qarte i problemit që duhet të zgjidhet nepermjet kesaj mikroteze
- Studimi i disa alternativave dhe krahasimi i tyre
- Një plan pune për hapat e mëtejshëm

Pas përfundimit të fazës orientuese këshillohet të realizohet një takim i ndërmjetëm me udhëheqësin në mënyrë që të diskutohen rezultatet e arritura deri në këtë moment si dhe të mirë përcaktohen hapat e rradhës.

2.3. Faza e tretë: hartimi i mikrotezës

Në këtë fazë fillon shkrimi i mikrotezës duke filluar me pjesën teorike ose studimin bibliografik dhe duke vijuar me kapitujt sipas rastit. Në materialin e shkruar duhet të jetë e qartë se cila është pjesa që është marrë nga literatura si dhe cila është puna konkrete që ka realizuar studenti.

Punimi pothuajse përfundimtar duhet t'i dërgohet udhëheqësit në kohë, në mënyrë që të jetë i mundur rishikimi i tij apo të bëhen ndryshime në lidhje me probleme të mundshme që mund të identifikojë udhëheqësi.

Punimi i përfunduar duhet të dorëzohet në dy kopje të printuara dhe lidhura si libër në Sekretarinë e Departamentit të Agromjedisit dhe Ekologjisë i firmosur nga studenti dhe udhëheqësi dy javë para datës së prezantimeve finale të diplomave. Gjithashtu, bashkë me mikrotezën duhet të dorëzohet një CD e materialit dhe prezantimit.

3. Struktura e mikrotezës

Punimi i mikrotezës duhet të strukturohet në jo më pak se 40 faqe dhe jo më shumë se 60 faqe A4 sipas si më poshtë:

- Kapaku
- Faqa zyrtare
- Dedikim
- Parathenie
- Përmbajtja
- Lista e tabelave, figurave, shtojcave
- Pëmbledhje
- Abstract..... përmbledhja (shqip) dhe abstract (anglisht) paraqet momentet kryesore rezultatet dhe përfundimet e punimit deri në 350 fjalë.
- Hyrje
- Kapitulli i parë: Vështrim bibliografik; qëllimi dhe objektivat e studimit

- Kapitulli i dytë: “Emërtimi..... Emrat e kapitujve nuk janë strikte, pasi në varësi të temës mund të ketë strukturime të ndryshme”
 - ⇒ Hyrje
 - ⇒ Materiali dhe metoda
 - ⇒ Rezultate dhe diskutime
 - ⇒ Përfundime dhe propozime
- Kapitulli i tretë: “Emërtimi.....”
 - ⇒ Hyrje
 - ⇒ Materiali dhe metoda
 - ⇒ Rezultate dhe diskutime
 - ⇒ Përfundime dhe propozime
- Referenca bibliografike

4. Formati i mikrotezës

Mikroteza duhet të paraqitet në format libri. Kapaku i mikrotezës duhet të jetë si në faqen në vijim:





Agricultural University of Tirana

UNIVERSITETI BUJQESOR I TIRANES

FAKULTETI I BUJQESISE DHE MJEDISIT

DEPARTAMENTI I AGROMJEDISIT DHE EKOLOGJISE

Mikrotezë

për mbrojtjen e gradës “Master Profesional”

Drejtimi

“Menaxhim Mjedisi

Tema:

“Tema e përzgjedhur për tu zhvilluar”

Punoi

Emër Mbiemër

Udhëhoqi

Grada. Emër Mbiemër

Tiranë, 2017



Agricultural University of Tirana

UNIVERSITETI BUJQESOR I TIRANES

FAKULTETI I BUJQESISE DHE MJEDISIT

DEPARTAMENTI I AGROMJEDISIT DHE EKOLOGJISE

Mikrotezë

për mbrojtjen e gradës “Master Profesional”

Drejtimi

“Menaxhim Mjedisi

Tema:

“Tema e përzgjedhur për tu zhvilluar”

Punoi

Emër Mbiemër

(_____)

Udhëhoqi

Grada. Emër Mbiemër

(_____)

Tiranë, më ____/____/____

5. Rregullat e shkrimit

Faqe A4, shkrimi duhet të jetë Times New Roman 13, Line Space duhet të jetë 1.5; margins duhet të jenë: Top, Bottom, Left, Right 1”.

Titujt duhet të jenë Times New Roman 14 bold për Headind 1, Times New Roman 13 bold për Headind 2; Times New Roman 12 bold për Headind 3.

5.1. Shkurtime dhe akronimet

Një shkurtime ose akronim (emër i shkurtër) përdoret vetëm në rastet kur shprehja e plotë është shumë e gjatë ose shkurtime është i njohur në fushën e kërkimit. Edhe në këto raste duhet të përdoret një formë e shkurtër e thjeshtë për tu kuptuar. Nëse do të përdoret një shkurtime atëherë kur të përdoret për herë të parë duhet të vendoset midis kllapave pas përcaktimit të parë të shprehjes së plotë.

Tabelat duhet të numërohen në mënyrë progresive me numra arab si më poshtë:

Tabela 1. Te dhënat për përmbajtjen e metaleve në tokë

| Nr | Emertimi | Përmbajtja në tokë mg/kgMTH | | |
|----|----------|-----------------------------|---|---|
| | | A | B | C |
| 1 | Cd | A | B | C |
| 2 | Co | W | C | D |
| 3 | Cr | W | Q | L |

Tabelat duhet të krijojnë në word Times 11.5.

Figurat ose grafikët duhet të numërohen në mënyrë progresive në fund me numra arab si më poshtë:




Figura 1. Paraqitje e marrdhenieve midis faktoreve.....

5.2. Standartet minimale për një mikroteze

Mikroteza është punimi që siguron një numër të konsiderueshëm kreditesh ndaj është e domosdoshme që çdo mikrotezë e paraqitur të përmbushë disa kritere ose standarte për kualifikim.

Tema duhet të jetë e shkruar në gjuhën letrare shqipe duke zbatuar me korrektësi rregullat e drejtshkrimit, dhe përdorur të gjithë shkronjat që përmban shqipja (përfshirë ë, ç, Ë, Ç).

Duhet të jetë e qartë se cila pjesë e temës është përshkrim i literaturës dhe cila është puna konkrete e realizuar nga diplomanti.

Mikroteza duhet të jetë firmosur paraprakisht nga udhëheqësi i saj.

KUJDES:

Në rast të evidentimit të rasteve të plagjiaturës së theksuar studenti përjashtohet menjëherë nga e drejta e prezantimit të mikrotezës.

6. Prezantimi

Prezantimi realizohet para komisionit në ditën e përcaktuar për çdo sezon dhe zgjat 10-15 minuta duke përfshirë dhe pyetjet e mundshme nga Juria.

Nëpërmjet prezantimit studenti duhet të shpalos njohuritë dhe aftësinë për ti treguar ose përçar ato tek të tjerët.

Prezantimi duhet të jetë një formë e veçantë dhe profesionale e komunikimit.

Prezantimi që nuk plotëson standartet nuk do të pranohet.

Në rast të tejkalimit të minutave të përcaktuara, komisioni është i detyruar të përfundojë prezantimin edhe në rast se ai nuk ka përfunduar akoma.